

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

AKTE

ÇMIME

LICENCA

Gjatë muajit janar Bordi i ERE-s ka zhvilluar 2 mbledhje, që kanë rezultuar në 10 vendimmarrje, të cilat lidhen me kompetencat e ERE në kuadër të:

DHËNIE, RINOVIM DHE HEQJE E LICENCAVE

- rinovimin e licencës së shoqërisë "SANG 1" shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,
- heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike me kërkesë të shoqërisë "Albanian Energy Supplier" sh.p.k.

PERCAKTIMI I ÇMIMEVE DHE TARIFAVE

- përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2023 prej 16.00 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Gjatë vitit 2023 çmimi i shitjes së energjisë nga FMF arriti pikën më të lartë gjatë muajve janar dhe shkurt me 32.24 Lekë/kWh, dhe pikën më të ulët gjatë muajit qershor me 14.22 Lekë/kWh.

HARTIMI DHE MIRATIMI I AKTEVE RREGULLATORE

Ndër vendimet që mund të përmendim është dhe fillimi i procedurës për miratimin e "Metodologjisë së Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni Ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës" si dhe fillimin e procedurës për miratimin e "Procedurave Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri - Kosovë".

Për palët e interesit që dëshirojnë të njihen me këto dokumente apo të përcjellin në ERE qëndrimin e tyre, këto dokumente gjenden të publikuara në faqen e web të ERE Konsultime: <http://www.ere.gov.al>.

Për tu bërë me dije me vendime në mënyrë më të detajuar ju, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

AKTIVITETE

SEANCA DËGJIMORE

NATIONAL ASSOCIATION OF REGULATORY UTILITY COMMISSIONERS ORGANIZOI NË TIRANË ME MBËSHTETJEN E USAID/ALBANIA, TRAJNIM PËR AUTORITETET RREGULLATORE NGA #EVROPA DHE #EURASIA NË NDËRGJEGJËSIMIN E BARAZISË GJINORE DHE NËN INICIATIVËN PËR AVANCIMIN E GRAVE LIDERË NË ENERGJI. TRAJNIMI NË BASHKËPUNIM ME #ERE KA PËR QËLLIM TRAJTIMIN E NORMAVE SOCIALE TË PADREJTA NË VENDIN E PUNËS DHE NDËRGJEGJËSIMIN PËR NDRYSHIME NË POLITIKA DHE PROCEDURAT E KOMISIONEVE. VLEN PËR TU PËRMENDUR QË 65% E POZICIONEVE TË PUNËS NË ERE PËRBËHEN NGA FEMRA, DISA PREJ TË CILAVE MBAJNË POZICIONE DREJTUESE DHE ROLE KYÇE NË ECURINË DHE VENDIMARRJEN E INSTITUCIONIT.



#GENDEREQUALITY
#WOMENINENERGYSECTOR
#USAID #NARUC

GJATË MUAJIT JANAR 2024, ERE KA PUBLIKUAR DISA NJOFTIME SI VIJOJNE:

NJOFTIM PER KONSUMATORËT QË NGA DATA 01.01.2024 KANË DALË NË TREG TË LIRË.

KONSUMATORËT TË CILËVE SIPAS PARASHIKIMEVE TË LIGJIT NR. 43/2015, U KA PËRFUNDUAR AFATI I FURNIZIMIT NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT (FSHU) DHE NGA DATA 01 JANAR 2024, JANË NË TREG TË LIRË, KANË TË DREJTË TË FURNIZOHEN NËPËRMJET FURNIZUESVE TË LICENCUAR QË OFROJNË KËTË SHËRBIM.

NJË KOPJE E LISTËS SË FURNIZUESVE QË OFROJNË KËTË SHËRBIM NË TREGUN E LIRË, MUND TA GJENI NË FAQEN E WEB TË ERE-S NË LINKUN E MËPOSHTËM: [HTTPS://WWW.ERE.GOV.AL/SQ/SHERBIME-KONSUMATORI/GJENI-FURNIZUESIN-TUAJ-NE-TREG-TE-LIRE](https://www.ere.gov.al/sq/sherbime-konsumatori/gjeni-furnizuesin-tuaj-ne-treg-te-lire).

PËR TU NJOHUR ME DISA KËSHILLA TË VLEFSHME PËR ULJEN E KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE; MBI PËRFITIMET E TË PATURIT NJË MATËS INTELIGJENT; FAKTE MBI MAKINAT ELEKTRIKE, INFORMACIONE MBI TË DREJTAT E KONSUMATORI APO PËR TU BËRË PJESË E ANKETËS SË KONSUMATORIT, NA NDIQNI JO VETËM NË FAQEN TONË ZYRTARE, POR DHE NË RRJETET SOCIALE [LINKEDIN](#), [FACEBOOK](#) DHE [INSTAGRAM](#).

Pjesë e aktivitetit të ERE-s kanë qënë dhe seancat dëgjimore me subjekte të licencuar si dhe palë interesi, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo përfitim të palëve me qëllim një vendimmarrje më të plotë. Ndër to mund të përmendim:

- pesë seanca dëgjimore të zhvilluara nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me subjekte të licencuara dhe palë të përfshira në proces ndër të cilët përmendim "ALBPETROL" sh.a, "DRINI BULQIZE" sh.p.k, "SGD ENERGJI" sh.p.k, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Dibër, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Skrapar dhe Gjirokastrë, "VOKOPOLA ENERGJI" shpk, "TIRANA ENERGJI" sh.p.k dhe "KALISI HYDROPOWER" sh.p.k; që në thelb kanë patur evidencime dhe sqarime të nevojshme për të çuar para procese si rinovim të licencës apo kërkesa të ndryshme, në zbatim të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike;

- dy seanca dëgjimore të zhvilluara nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve me konsumatorë familjar dhe biznes, me qëllim zgjidhjen e ankesave me të licencuarit përgjegjës si FSHU sh.a., OSSH sh.a. dhe Albpetrol sh.a. dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes tyre.